



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUSTEC

Nr. ____ Prot

Pustec, më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje projekti ndertim rruge.”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
71322500-6** Shërbime per projektme teknike te infrastruktures e trafikut

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **4 157 685** (kater milion e njeqind e pesedhjetë e shtate mije e gjashteqind e tetedhjetë e pese) lek pa TVSH.

Sqarim: Referuar VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” u përllogarit dhe fondi limit si më poshtë:

Vlera e investimit e parashikuar përafërsisht nga Bashkia Pustec për objektet: **“Blerje projekti ndertim rruge.”** është 175 000 000 lekë pa Tvsh.

- Objekti i mësipërm bën pjesë në: **Seksioni III “Vepra Inxhinjrike”.**

A - Për këtë në bazë të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, u hap faqja e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik nga ku u morrën dokumentat standarte të tenderit. Këto dokumenta u përzgjedhen për procedurën e përcaktuar në Urdherin e Prokurimit **Nr.7 datë 20.05.2026** dhe u proçedua si me poshtë:

1. U plotësuan dokumentat e tenderit të mësipërm sipas Dokumentave Standarte të tenderit dhe u përgatiten për hedhjen në sistem.

2. Kërkesat e Përgjithshme për kualifikim të mbeten ato që përcaktohen në Dokumentat Standarte.
3. Kërkesat e veçanta për kualifikim të vendosen si më poshtë:

Për përllogaritjen e fondit limit, AK i është VKM Nr .354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim” u përllogarit dhe fondi limit si më poshtë:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Pustec** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 83 153(tetëdhjete e tre mijë e njëqind e pesëdhjete e tre) lekë pa Tvsh, të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. *Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

- 2.2.2 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2023, 2024, 2025**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50% e fondit limit të kontratës që prokurohet, perkatesisht 2 078 845 (dy milion e shtatedhete e tete mije e teteqind e dyzet e pese) leke pa tvsh.
(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

- 2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të objektit që prokurohet, perkatesisht 2 078 845 (dy milion e shtatedhete e tete mije e teteqind e dyzet e pese) leke pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën ,vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, **DHE** faturave tatimore të

shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën e bashkimit të operatoreve dhe prokurën e posacme, të deklaruara në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.
- **Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 50 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.*
- *Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:*
- *Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

1. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

Kat. 3/d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe forcim i strukturave mbajtëse prej beton-
arme, murature dhe metalike.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

Kat. 5/c – Ujësjellës - kanalizime urbane - rurale.

6. PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA

Kat. 6/a – Projektim rruge lokale, rrugë urbane dytësore dhe rruge interurbane dytësore.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

Kat. 7/a – Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m.

8. PROJEKTUES GJEODET

Kat. 8/a – Rilevime inxhinierike.

Kat. 8/d – Bazamente gjeodezike.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK - HIDROGJEOLOGJIK

Kat. 9/d – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR.

Kat. 11/a – Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

Kat. 11/d – Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë **Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (leshuar nga MZHUT** ose institucione të tjera të autorizuara sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për çdo kategori si më poshtë:

1. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

Kat. 3/d – Vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe përforcim i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike. Projektuesi konstruktor harton projektin e strukturave mbajtëse prej beton-arme që do të ndërtohen përgjatë segmentit rrugor, duke përfshirë muret mbajtës, tombinot, portalet dhe pusetat. Llogarit kapacitetin mbajtës të këtyre strukturave duke marrë parasysh ngarkesat statike nga shtypja e dheut, ngarkesat dinamike nga trafiku rrugor, si dhe ngarkesat sizmike sipas kushteve teknike të projektimit. Përcakton dimensionet e seksioneve, klasën e betonit, sasinë dhe vendosjen e armaturës, duke siguruar qëndrueshmërinë statike dhe sizmike të veprave të artit në kushte shfrytëzimi normal dhe të jashtëzakonshme.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

Kat. 5/c – Ujësjellës – kanalizime urbane – rurale. Projektuesi i veprave hidraulike harton projektin e sistemit të kullimit të ujërave sipërfaqësore nga karrexhata dhe sipërfaqet anësore të rrugës, duke përfshirë kanalet anësore, tombinot tërthore, pusetat e mbledhjes, gypat e shkarkimit dhe daljet në recipientët natyrorë. Llogarit prurjet maksimale të ujërave të shiut, përcakton diametrat dhe pjerrësitë e tubave, si dhe dimensionon pusetat e kontrollit dhe pusetat e mbledhjes së ujërave, duke siguruar largimin efikas të ujërave nga trupi rrugor.

6. PROJEKTUES RRUGË – HEKURUDHA

Kat. 6/a – Projektim rruge lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore. Projektuesi i rrugës harton planimetrinë e përgjithshme, profilin gjatësor dhe profilet tërthore të segmentit rrugor. Përcakton elementët gjeometrikë të rrugës (kthesat horizontale dhe vertikale, gjerësinë e karrexhatës, banketet, trotuaret, brigjet e gërmimit dhe mbushjes), duke respektuar shpejtësinë e projektimit dhe standardet teknike sipas kategorisë së rrugës. Projekton strukturën e shtresave të trupit rrugor, duke përfshirë shtresat e çakëllit, gjeotekstilin ndarës, shtresën e binderit dhe shtresën veshëse të asfaltbetonit, bazuar në ngarkesat e trafikut dhe karakteristikat gjeoteknike të truallit. Përfshin gjithashtu projektimin e trotuareve, bordurave, sistemimin e brigjeve dhe zgjidhjen e lidhjeve me rrjetin ekzistues rrugor.

7. PROJEKTIM URA DHE VEPRA ARTI

Kat. 7/a – Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m. Projektuesi i veprave të artit harton projektin e veprave të artit të vogla që do të ndërtohen përgjatë trasesë rrugore, si tombino, portale dhe struktura të tjera me hapje deri në 10 m. Përcakton llojin e konstruksionit prej beton-arme monolit, llogarit ngarkesat e trafikut sipas standardeve në fuqi dhe ngarkesat hidraulike të prurjeve maksimale, dimensionon elementët mbajtës dhe themelet, si dhe siguron qëndrueshmërinë statike, dinamike dhe sizmike të veprës.

8. PROJEKTUES GJEODET

Kat. 8/a – Rilevime inxhinierike. Projektuesi gjeodet kryen rilevimin inxhinierik topografik të trasesë rrugore ekzistuese dhe të terrenit përreth, që shërben si bazë teknike për hartimin e projektit. Përfshin matjen e koordinatave, kuotave të terrenit, elementëve ekzistues (vepra arti, ndërtime, rrjete inxhinierike nëntokësore dhe mbitokësore), si dhe hartimin e planimetrisë së gjendjes ekzistuese të nevojshme për llogaritjen e volumeve të gërmim-mbushjeve dhe për projektimin e profileve gjatësore e tërthore.

Kat. 8/d – Bazamente gjeodezike. Projektuesi gjeodet krijon rrjetin e pikave gjeodezike të bazamentit (poligonometrike dhe të nivelimit) përgjatë trasesë rrugore, të cilat shërbejnë si pika referimi të qëndrueshme për të gjitha matjet topografike gjatë fazës së projektimit, si dhe për piketimin dhe kontrollin gjeodezik të veprës gjatë fazës së zbatimit të punimeve.

9. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK – HIDROGJEOLOGJIK

Kat. 9/d – Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët. Projektuesi gjeolog kryen studimin gjeologo-inxhinierik dhe hidrogjeologjik të trojeve përgjatë trasesë rrugore, duke vlerësuar karakteristikat e shtresave dhe qëndrueshmërinë e shpateve anësore. Harton raportin teknik me karakteristikat gjeomekanike të shtresave, prezencën e ujërave nëntokësore dhe parametrat e nevojshëm për dimensionimin e themeleve të mureve mbajtës dhe veprave të artit. Propozon masat e nevojshme për sigurimin e qëndrueshmërisë së shpateve dhe drenazhimin e ujërave, duke garantuar sigurinë e trupit rrugor.

11. PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR

Kat. 11/a – Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime. Projektuesi harton projektin e sinjalistikës horizontale (vijëzimi gjatësor dhe anësor i karrexhatës, ndarjet e korsive, kalimet e këmbësorëve, simbolet dhe shkrimet në rrugë) dhe të sinjalistikës vertikale jondriçuese (tabelat paralajmëruese, ndaluese, detyruese dhe informuese të llojeve të ndryshme), duke përfshirë përcaktimin e tipit, dimensioneve, vendndodhjes dhe mënyrës së fiksimit. Përfshin gjithashtu projektimin e barrierave anësore mbrojtëse (guardrail) sipas standardeve në fuqi dhe Kodit Rrugor.

Kat. 11/d – Sinjalistikë ndriçuese në infrastrukturë. Projektuesi harton projektin e sistemit të ndriçimit rrugor përgjatë segmentit, duke përfshirë shtyllat metalike të ndriçimit, ndriçuesit LED, kuadrin e komandimit dhe rrjetin e furnizimit elektrik me kablllo dhe tokëzim. Harton llogaritjet fotometrike, skemën elektrike të furnizimit dhe komandimit, si dhe sistemin e mbrojtjes, duke siguruar funksionimin e sigurt dhe të vazhdueshëm të trafikut në kushte të kufizuara dukshmërie.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (nje) projektues Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (nje) projektues Inxhinier Hidroteknik;
- 1 (nje) projektues Inxhinier Gjeodet /Topograf/Markshajder;
- 1(nje) projektues Inxhnier Gjeolog
- 1(nje) projektues Inxhnier Elektrik

Për stafin e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Kontratat individuale të punes (të vlefshme), Licencat profesionale, Diplomë, CV.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë sipas shtojces 5, *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per muajin e fundit te deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.*

Drejtimesit teknik si më sipër duhet të jenë të punësuar prane shoqerise dhe të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të vendimit nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit te Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Stafi i mesiperm, do te realizoje projektet sipas kompetences dhe licences bazuar ne VKM nr.759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndertim”. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për çdo punonjës si më poshtë:

1. Projektues Inxhinier Ndërtimi

Inxhinieri i Ndërtimit është figura kryesore e projektit. Ai harton planimetrinë e përgjithshme, profilin gjatësor dhe profilet tërthore të segmentit rrugor, dimensionon shtresat e trupit rrugor dhe projekton strukturat mbajtëse prej beton-arme (mure mbajtës, tombino, puseta). Pa praninë e tij është e pamundur hartimi i projektit teknik të rrugës dhe i veprave të artit.

2. Projektues Inxhinier Hidroteknik

Inxhinieri Hidroteknik është i domosdoshëm për projektimin e sistemit të kullimit të ujërave të shiut. Ai llogarit prurjet maksimale, dimensionon kanalet anësore, tombinot tërthore dhe pusetat e mbledhjes, si dhe përcakton diametrat dhe pjerrësitë e tubave, duke siguruar largimin efikas të ujërave nga trupi rrugor.

3. Projektues Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder

Inxhinieri Gjeodet kryen rilevimin topografik të trasesë rrugore dhe krijon rrjetin e pikave gjeodezike të bazamentit. Pa rilevimin gjeodezik është e pamundur hartimi i projektit teknik, llogaritja e volumeve të gjërmim-mbushjeve dhe piktimi i veprës në fazën e zbatimit.

4. Projektues Inxhinier Gjeolog

Inxhinieri Gjeolog vlerëson karakteristikat gjeomekanike të trojeve dhe qëndrueshmërinë e shpateve anësore përgjatë trasesë. Studimi i tij siguron të dhënat e domosdoshme për dimensionimin e themeleve të mureve mbajtës dhe të vetë trupit rrugor, duke shmangur rrezikun e dëmtimeve afatgjata.

5. Projektues Inxhinier Elektrik

Inxhinieri Elektrik harton projektin e ndriçimit rrugor (shtylla, ndriçues LED, kuadër komandimi, rrjet kabllor dhe tokëzim), si dhe projektin e sinjalistikës rrugore. Pa praninë e tij projekti do të ishte i paplotë në aspektin e sigurisë rrugore dhe të infrastrukturës elektrike.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë staf jodomosdoshmerisht në licensen e shoqërisë për realizimin e këtij shërbimi punonjësit e mëposhtëm:

- 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

*Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomën, kontratën individuale të punës (të vlefshme), si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, **Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per muajin e fundit te deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.***

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ , te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis -Eksperti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është i nevojshëm për hartimin e raportit mjedisor të projektit, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit. Ai vlerëson ndikimet e mundshme të punimeve të rikonstruksionit në ajër, ujë, tokë, florë, faunë dhe në komunitetin përreth, duke analizuar veçanërisht efektet nga gërmimet, transporti i materialeve, prishja e strukturave ekzistuese dhe shtrimi i shtresave asfaltike. Propozon masat zbutëse dhe parandaluese për minimizimin e ndikimeve negative gjatë fazës së zbatimit dhe të shfrytëzimit. Prania e tij është e detyrueshme për pajisjen e projektit me lejen mjedisore dhe për garantimin e zbatimit të standardeve mjedisore kombëtare.

- 1 (një) *Ekspert* Zjarrëfikës ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe per shpetim, i certifikuar nga Drejtoria MZSH në përputhje me Ligjin Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin”, për të cilin operatori ekonomik duhet të paraqesë, kontratë individuale pune të vlefshme, CV, Diplome/certificate dhene nga Drejtoria MZSH. (sipas legjislacionit në fuqi), ***Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore muajin e fundit te deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi.***

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“ , te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

Ekspert Zjarrfikës-Eksperti Zjarrfikës, i certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së në përputhje me Ligjin Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", është i nevojshëm për vlerësimin e aspekteve të sigurisë nga zjarri përgjatë segmentit rrugor. Ai harton masat parandaluese për mbrojtjen nga zjarri gjatë fazës së zbatimit të punimeve, vlerëson aksesin e mjeteve të shërbimit zjarrfikës përgjatë trasesë rrugore dhe siguron që projekti të jetë në përputhje

me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin. Prania e tij është e detyrueshme për miratimin e projektit nga organet kompetente.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **7 (shtate) punonjes të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për muajin e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore minimumi për tre muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listëpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi minimumi për tre muajt e fundit të deklaruar.

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me realizimin e suksesshëm të shërbimit për objektin..

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH DIN EN UNI **ISO 9001-2015 e perditesuar** (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH DIN EN UNI **ISO 14001-2015 e perditesuar** (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH EN UNI **ISO 45001:2018 e përditësuar**, (SSH DIN EN UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.7 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

-1(një) Pajisje për matjet gjeodezike GPS;- Per kete duhet te paraqesë fature tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku i bashkengjitet fatura tatimore.

-1(një) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station.- Per kete duhet te paraqesë fature tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku i bashkengjitet fatura tatimore.

-1(një) Pajisje dron profesional- Per kete duhet te paraqesë fature tatimore shit-blerje ose kontrate qiraje/bashkepunimi ku i bashkengjitet fatura tatimore.

-1(një) Automjet - Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: çertifikaten e pronesise; leja e qarkullimit; çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore.

Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

Për plotësimin e kësaj kërkesë duhet të paraqitet një dokument i cili vërteton pronësinë ose aktin e marrjes me qera të tyre si dhe skeda teknike e këtyre pajisjeve.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë pajisje, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me realizimin e shërbimit.

Shënim: Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJESIA E PROKURIMIT